



UNIVERSITETI  
UNIVERSITY  
UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Nr. 1437 dt. 12.06.2017

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

**Pejë, 12.06.2017**

Në bazë të nenit 19, paragrafi 1, të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të dispozitave të nenit 17, nenit 23 paragrafi 1.9, nenit 27 paragrafët 2,3,4,5 dhe nenit 31 paragrafi 6, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur me datë 12.06.2017 ka nxjerr Vendimin me Ref. Nr. 1436 të datës 12.06.2017 për shpalljen e:

### **KONKURSI**

Për zgjedhjen e Rektorit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë

Konkurrimi për postin e Rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm

Sipas nenit 27 të Statutit të Universitetit për Rektor duhet të plotësohen këto kushte:

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencore;
2. Të ketë gradën më së paku të Profesorit të Asocuar;
3. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare.

### **Kushtet e veçanta**

1. Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet formale për detyrën e Rektorit duhet të plotësojnë edhe këto kushte:
  - a. Të përgatisin një dosje me dokumentacion konkret dhe të besueshëm për thirrjet akademike dhe shkencore;
  - b. Dokumenteve të ia bashkëngjisin një CV të detajuar mbi punën menaxheriale, akademike, shkencore ose artistike;
  - c. Të jenë të gatshëm të intervistohen nga Këshilli Drejtues në mënyrë që të prezantojnë një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe për qasjen e tij menaxhuese.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë ) ditë nga dita e shpalljes publike në mjetet e informimit dhe në web-in e universitetit: [www.unhz.eu](http://www.unhz.eu)

Dokumentacioni i të interesuarve dorëzohet në Rektoratin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, ose përmes postës zyrtare në adresën: **Rektorati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Rr. UÇK-së 30000 Pejë.**